

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BONNIE Sh. p. k

Sot më datë 27.08.2024, si themelues me të dhënat e mëposhtme :

- Z. XHEK NASUFI, shtetas shqiptar, lindur në Slloveni, më 02/07/1994, resident në Tirane , me Nr.karte Identiteti J40702054T

ka vendosur te nënshkuajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statusi i saj,

Neni 1- Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është " **BONNIE** " Sh.p.k

Neni 2- Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati i 1, Apartamenti 08, Tiranë.
- 2.2 Transferimi i Selisë së shoqërisë në një vend tjetër do te bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.
- 2.3 Asambleja e Ortakëve do të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe zyrave përfaqësuese në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Neni 3- Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pacaktuar.
- 3.2 Shoqëria mund të shpërbëhet më përpara ose të zgjatet kohëzgjatja e saj me Vendim të Ortakëve.

Neni 4- Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi.

- 4.1 Sherbime ne fushen e bareve, restoranteve
- 4.2 Sherbim catering (shpermdarje)
- 4.3 Tregtim me pakicë dhe shumicë të produkteve ushqimore
- 4.4 Organizim eventesh shoqerore, artistike, muzikore, sportive, koncerte, spektakle, evente familjare private, etj

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar është 100,000 (njëqindmijë) lekë.



5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuota , e gjitha të nënshkruara dhe per tu shlyer, me vlerë nominale 100,000 (njëqindmijë) lekë.

Neni 6 – Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë :

- Z. XHEK NASUFI, shtetase shqiptare ofron nje kontribut në para të barabartë me 100,000 (njëqindmijë) lekë.

6.2 Sipas kontibuteve të mësipërme :

- Z. XHEK NASUFI, i përket 1 kuote, që i korrespondon 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

7.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

7.2 Në rastin e transferimit të cdo lloj titulli, qoftë kundrejt një pagese apo jo në kuptimin më të gjerë të fjalës, pra duke përfshirë dhurimin e aksioneve dhe personave të tjerë të ndryshëm nga ortakët, aksionet duhet të ofrohen me refuzimin e parë të Ortakëve të tjerë.

7.3 Në këtë rast ortaku shitës duhet tju komunikojë me shkrim ortakëve të tjerë, me anë të një letre rekomanduese a/r ku të shprehet qartë, vullneti për të shitur aksionet, kushtet e shitjes përfshirë emrin e blerësit, emrin e shitësit, cmimin e shitjes. E drejta e parablerjes duhet ti referohet gjithsesi të gjitha kuotave të ofruara për shitje.

7.4 Anëtarët do të kenë 30 (tridhjetë) ditë kohë nga marrja e letrës a / r për të informuar aksionarin shitës për gatishmërinë e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Në rast të skadencës së afatit kohor, e drejta e parablerjes në favor të tyre do të bie poshtë.

7.5 Në rastin kur oferta pranohet nga shumica e Ortakëve, aksionet e shitura nga aksioneri ndahen në mënyrë proporcionale në bazë të aksioneve që zoterojnë secili prej tyre (pala blerese), nese nuk bëhet një marrëveshje ndryshe ndërmjet palëve. Në asnjë rast ofruesi nuk do të pranojë një ushtrim pjesor të së drejtës së parablerjes.

7.6 Në rast të dështimit për të ushtruar të drejtën e parablerjes, aksionet mund të transferohen drejt palëve të treta në tërësi ose në pjesë.

7.7 Njësitë mund të transferohen me anë të trashëgimisë në raste fatkeqësie.

Neni 8 – Administrimi

8.1 Shoqëria administrohet gjithashtu dhe nga një Administrator i cili qëndron në detyrë deri në shkarkimin ose dorëheqjen e tij, ose për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet.

8.2 Përfaqësimi ligjor i shoqërisë do ti ngarkohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat në përputhje me dispozitat e nenit 95 të Ligjit nr. 9901 të datës 14. 04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



8.3 Administratori mund të emerojë Prokurorë special për akte specifike ose kategori të ndryshme aktesh.

8.4 Administrator i pare i shoqerise emerohet z.Xhek Nasufi i lindur ne Slloveni, me_02/07/1994_, mbajtes i leternjoftimit/pasaportes nr. J40702054T.

Neni 9 – Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

* * *

ORTAKU



Z. XHEK NASUFI